

Sinjalizime

Ekskluzive | Breshëri plumbash në një ndërtesë në Mitrovicë – qëllohet nga dy anët, dy vëllezër në kërkim për tentim-vrasje



Sinjali.com

10 Gusht 2026 09:37



Një incident i rëndë me të shtëna me armë zjarri ka ndodhur pasditen e së dielës në sheshin “Isa Boletini” në Mitrovicë, ku dyshohet se është qëlluar me armë nga dy palë brenda korridorit të një ndërtese banimi.

Sinjali mëson se lidhur me rastin si të dyshuar janë identifikuar Endri Cakiqi rreth 18 vjeç dhe Albi Cakiqi 24-vjeç, ndërsa rasti po hetohet si “Vrasje në tentativë”.

Ngjarja është raportuar më 9 gusht, rreth orës 15:30, pasi Policia ka marrë informacion për të shtëna me armë zjarri në këtë lokacion.

Kur njësitë policore kanë mbërritur në vendin e ngjarjes, kanë hasur në shenja që dëshmojnë për seriozitetin e përplasjes. Dera e banesës ku jetojnë të dyshuarit kishte vrima nga predhat, ndërsa dyshohet se nga brenda banesës ishte shtënë në drejtim të disa personave që ndodheshin në korridor.

Por dyshimet janë se të shtënat nuk kanë ardhur vetëm nga njëra anë.

Në korridor janë gjetur disa gëzhoja që dyshohet se u përkasin kalibrave të ndryshëm dhe së paku dy armëve, ndërsa nga të shtënat janë dëmtuar dera e banesës së të dyshuarve dhe dera e banesës përballë.

Këto prova kanë ngritur dyshimet se në incident është qëlluar me armë nga të dyja palët.

Njësia e Hetimeve Rajonale ka kryer ekzaminimin e vendit të ngjarjes dhe ka sekuestruar gëzhojat dhe predhat e gjetura për ekzaminime të mëtejshme.

Personat që ndodheshin në banesë janë larguar pas incidentit dhe vendndodhja e tyre nuk dihet, ndërsa deri më tani nuk është bërë i ditur motivi që çoi në përplasjen e armatosur.

Për rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar inicimin e hetimeve për veprën penale “Vrasje në tentativë”.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/


Armë

Mitrovicë

Policia

tentimvrasje

Të tjera:



Shpëtohet mrekullisht fëmija pas rënies në ujë në një restorant në Mitrovicë, dërgohet në...

Siguri



Gjendet pa shenja jete në banesën e saj në Mitrovicë, nis hetimi për vdekjen e 76-vjeçares

Sinjalizime



Parandalohet tjetërsimi i 21 pronave në Mitrovicë, arrestohen tre persona

Siguri




Ekskluzive | E goditi me shuplakë të miturin dhe videoja u bë virale – Policia arreston 19-...

Sinjalizime



Kontrolli policor në Mitrovicë i zbulon boks hekuri 17-vjeçarit, nis hetimi për armëmbajtje

Sinjalizime



Mitrovicë| Shkeli urdhrin mbrojtës të Gjykatës, dyshohet se e telefononte dhe i...

Sinjalizime



Tragjike| 40-vjeçarja ndërron jetë papritur në Mitrovicë, familja kërkon obduksion

Sinjalizime



Sulmohet nga vjehrra në Mitrovicë, Policia nis hetimet për dhunë në familje

Siguri

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera